# DËSHMI ARKIVI

**A-478975**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Përmbytje masive në Indi dhe Nepal, dhjetëra viktima dhe mijëra banorë në rrezik |
| ADRESA | `https://piranjat.al/bota/permbytje-masive-ne-indi-dhe-nepal-dhjetera--dhe-mijera-banore-ne-rr-i106580` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 11:39:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 11:31:03 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7f7e53a21e19147213cf8e40589b5fceaadc47a8444a248e94f330a5e312ed07` |
| TEKSTI | `c62c8d16484b007da65812dd6b894fda34fad5a062318a67239490a941d409c9` |
| PAMJA | `8017e428eee2c6d3285b37dbfdf4a435b25394e730e89677987cabc0f3ba9af9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b917831e0fbcfac8bb7eba09da0b1074eda2472d534dc427bb4742678a095645` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5a00511fec2dd72c79527889eef91c0b757bfc2cb84c819aee6ec0978e94e200` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b917831e0fbcfac8bb7eba09da0b1074eda2472d534dc427bb4742678a095645`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA

# Përmbytje masive në Indi dhe Nepal, dhjetëra viktima dhe mijëra banorë në rrezik

Piranjat Përditësimi i fundit 29 Shtator 2026, 13:31



Reshjet e dendura të shiut kanë shkaktuar përmbytje dhe rrëshqitje dherash në Indi dhe Nepal, duke shkaktuar të paktën 68 viktima në të dyja vendet. Në shtetin verior indian të Uttar Pradesh, të paktën 56 persona kanë humbur jetën gjatë ditëve të fundit, ndërsa 46 të tjerë janë plagosur.

Komisioneri i Ndihmës së Uttar Pradesh, Hrishikesh Bhaskar Yashod, bëri të ditur se nga e premtja deri të dielën në mëngjes, në këtë shtet janë regjistruar 66.5 milimetra reshje, ndërsa norma për këtë periudhë është vetëm 7.6 milimetra. Sipas autoriteteve, reshjet e përshkruara si jashtëzakonisht të dendura kanë prekur pjesën më të madhe të Uttar Pradesh dhe kanë dëmtuar më shumë se 1,000 banesa.

Situata është përkeqësuar pasi një zonë presioni të ulët e formuar mbi Gjirin e Bengalit ka lëvizur drejt tokës, duke intensifikuar reshjet në rajon. Uttar Pradesh, shteti më i populluar i Indisë me më shumë se 240 milionë banorë, përballet rregullisht me reshje të dendura dhe stuhi gjatë sezonit të musonit, që zgjat nga qershori deri në shtator.

Në shtetin lindor të Odishës, më shumë se 70,000 banorë të zonave të ulëta janë evakuuar pasi lumenjtë kanë dalë nga shtrati si pasojë e reshjeve të shumta. Përmbytjet kanë dëmtuar ura dhe kalime rrugore, ndërsa autoritetet kanë mbyllur edhe një prej destinacioneve turistike më të njohura, Devkund.

Komisioni Qendror i Ujërave i Indisë ka paralajmëruar gjithashtu për situatë të rënduar në 30 pika monitorimi të lumenjve në shtatë shtete. Disa prej lumenjve kryesorë, përfshirë Gangun, Gandakun, Kosin, Bagmatin dhe Narmadën, kanë kaluar nivelet e rrezikut.

Ndërkohë, në Nepalin fqinj, përmbytjet dhe rrëshqitjet e dherave kanë shkaktuar të paktën 12 viktima që nga e enjtja, ndërsa disa persona rezultojnë ende të zhdukur. Autoritetet kanë paralajmëruar për rrezik të përmbytjeve të menjëhershme në 49 nga 77 distriktet e vendit, ndërsa më shumë se gjysma e territorit përballet me rrezik të lartë nga përmbytjet ose vërshimet e shpejta.

Situata është veçanërisht shqetësuese për Nepalin, i cili ende po përballet me pasojat e përmbytjeve shkatërruese të fundit të gushtit, ku më shumë se 1,400 persona humbën jetën dhe mijëra të tjerë rezultuan të zhdukur.

## Artikuj te sugjeruar

BOTA 29 Shtator13:10

### [Skenar si nëpër filma, zhduken 39 kg kokainë në një sallë gjyqi në Fixhi! Ishte zëvendësuar me miell]

Kokainë me vlerë deri në 31 milionë dollarë është zëvendësuar me miell në një sallë gjyqi në ...

BOTA 29 Shtator13:04

**Kremlini: Rusia dëshiron që Irani të mbetet pjesë e traktatit bërthamor**

Rusia i kërkoi të martën Iranit të mbetet "një palë përgjegjëse" e Traktatit të Mospërhapjes (NPT)...

BOTA 29 Shtator12:43

**Argjentina kërcënon Britaninë me padi ndërkombëtare për naftën në Ishujt Falkland**

Presidenti i Argjentinës Javier Milei ka kërcënuar se do të ndërmarrë hapa ligjorë kundër Mbretërisë së...

Piranjat News BOTA 29 Shtator09:54

**Koreja e Veriut vazhdon të forcojë Rusinë kundër Ukrainës: Do të dërgojë edhe 10,000 ushtarë të tjerë**

Më shumë se 8,000 ushtarë të Koresë së Veriut ndodhen aktualisht në tokën ruse, ndërsa po bëhen përgati...

BOTA 29 Shtator09:48

**Ushtria izraelite vret komandantin e lartë të Hamasit**

Një sulm ajror izraelit vrau të martën Izz al-Din Al-Beik, kreun e krahut të armatosur të Hamasit në Rripin verior të Gaz&e...

BOTA 29 Shtator09:30

**Trump hedh poshtë raportimet mediatike: Nuk i kam ofruar asgjë Iranit. Do bisedojmë, por nuk përjashtojmë as sulmet**

Presidenti amerikan Donald Trump ka mohuar kategorikisht raportimet se Shtetet e Bashkuara i kanë ofruar Iranit lehtësim të sanksioneve dhe zhb...

Piranjat News BOTA 29 Shtator09:05

**Qeveria greke do të subvencionojë deri në 10,000 euro çdo grek që do të zhvendoset në fshatrat e Çamërisë**

Me një mbështetje deri në 10,000 euro , e cila në fazën e re është planifikuar të paguhet përgjysmë para zhv...

BOTA 29 Shtator08:24

**Trump njoftoi ndërtimin e fabrikës gjigante të çelikut në Iowa: Më e madhe e në historinë e SHBA-së**

Presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar ndërtimin e një fabrike gjigante çeliku në Iowa, një projekt që sipas tij do t&eu...

BOTA 28 Shtator23:17

**Infermieri sulmon seksual*sht pacienten në gjendje agonie, burgoset për 7 vite**

Një infermier i paskrupullt, i cili abuzoi seksualisht me një grua pasi asaj i ishte hedhur një substancë në pije, është d&eu...

BOTA 28 Shtator23:11

**Dy republikanë kërkojnë nga administrata Trump që të vazhdojnë sanksionet ndaj Industrisë së Naftës së Serbisë**

Dy kongresistë republikanë në SHBA i kanë kërkuar administratës së presidentit Donald Trump që të mos ia zgjasë...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 28 Shtator

**VIDEO tronditëse/ Oficeri i policisë në pension...**

Ali Sekeroğlu kishte bërë thirrje për pjesëmarrje në një demonstratë kundër pensioneve të pamjaftueshme, përme...

BOTA 28 Shtator

**Krimi horror/ Pedagogia 'Satana' copëtoi trupin...**

Është Nicole Formichetti, 46 vjeçe, pedagogia që jetonte në apartamentin në rrugën "Tommaso Gulli" në Tori...

AKTUALITET 28 Shtator

**Humbën jetën anëtarët e familjes shqiptare, zba...**

Rrjedhja e gazit natyror që shkaktoi shpërthimin me shumë viktima në një ndërtesë në Plaka nisi nga apartamenti i katit ...

Piraniat News INVESTIGIME 29 Shtator11:57

[“2200 euro për person, kesh çdo ditë”/ Zbulohet skema si grupet kriminale rekrutojnë shoferët për transportin e emigrantëve ilegalë]

Një rrjet i organizuar që vepron përtej kufijve dhe që dyshohet se përfiton shuma të konsiderueshme nga trafikimi i emigrant&eum...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**



**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.